



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:288328
Datë: 26.08.2024
Numri i dokumentit: 06084373

C.nr. 4408/23.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti Përgjithshëm, sipas gjyqtarit Migjen Kastrati, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh.R, C.B R, E.K dhe V.K, e lindur B, të gjithë nga fshati V, Komuna e Pejës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ardit Ibraj, avokat në Pejë, kundër të paditurve: A.E dhe J.E, të dytë nga fshati V, Komuna e Pejës, me bazë juridike vërtetim të drejtës se pronësisë, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës, me date 26.08.2024 bie këtë :

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET SI E TËRHEQUR** padia e datës 20.12.2023 me numër C.nr. 4408/23 e paditësve Sh.R, C.B R, E.K dhe V.K, e lindur B, të gjithë nga fshati V, Komuna e Pejës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ardit Ibraj, avokat në Pejë, kundër të paditurve: A.E dhe J.E, të dytë nga fshati V, Komuna e Pejës, me bazë juridike vërtetim të drejtës se pronësisë vlera e kontestit e pa përcaktuar.
- II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë.
- III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre me datën 20.12.2024 kanë parashtruar padi kundër të paditurve, me bazën juridike, vërtetim të drejtës se pronësisë vlera e kontestit e pa përcaktuar.

Me parashtrësën e datës 08.08.2024 i autorizuari i paditëseve Ardit Ibraj avokat nga Peja, ka bërë tërheqjen e padisë për lëndën C.nr. 4408/23.

Meqenëse e të paditurit nuk ka dhënë përgjigje në padi me shkrim, gjykata të njëjtëve nuk ju ka dërguar parashtresën për tërheqje të padisë.

Sipas dispozitave ligjore nga neni 261 par. 1,2,3,4,5 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se: “pala paditëse ka të drejtë ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri të paraqet përgjigjen në padi, padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë. Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë. Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri”, u vendos si në piken **I** dhe **II** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së, si në piken **III** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet ligjore komform dispozitave ligjore nga neni 261 e lidhur me nenin 387 par.1 pika ‘c’ dhe nenit 142.1 të LPK, duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:288328, C.nr. 4408/23 i dt. 26.08.2024

Gj y q t a r i

Migjen Kastrati

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të dispozitës së nenit 261 par. 4 të LPK-së.